



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:100890

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06295292

C.nr. 553/2022

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtarja Mevlide Shabani, me zyrtaren ligjore Liridona Shabani, në çështjen kontestimore të paditësit A. L., nga fshati K. Komunae e Gjilanit, kundër të paditurve G. S. S. dhe G.S. S. nga fsh.K., Komuna e Gjilanit, tani me vendbanim te përhershëm ne K., Republika e Serbise, të cilet i përfaqëson S. Z., jurist nga Gjilani, për vërtetimit e të drejtës së pronësisë, pas mbajtjes së seancës gjyqësore më datë 01.10.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Në bazë të pohimit**

**I.APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditësit A. L. nga fshati K., Komuna e Gjilanit, e paraqitur kundër të paditureve G. S. S. dhe G. S. S. nga fsh.K., Komuna e Gjilanit dhe **VËRTETOHET** se paditësi në bazë të mbajtjes, është pronar i ngastrës kadastrale P-.....-.....-0 ZK Gjilan, në sipërfaqe prej 5689 m2 ne vendin e quajtur “S. Z.” dhe ngastrën kadastrale P-.....--0 Z K K., në sipërfaqe prej 1898 m2 në vendin e quajtur “V-”, sipas certifikatës pronësore me numër të lëndës .....-22 të datës 16.05.2022, ashtu që **DETYROHEN** te paditurit, që t’ia njohin këtë të drejtë paditësit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

**A r s y e t i m**

Paditësi A. L., nga fsh.K. K.Gjilanit, në këtë gjykatë më datë 18.05.2022, ka ushtruar padi kundër të paditureve, G. S. S. dhe G.S. S., nga fsh.K. Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes, duke theksuar se në vitet e 80-ta, babai i tij tani i ndjere A.L., me ane te kontratës gojore, i kishte blere ngastrat kadastrale P-.....-.....-0 ZK Kmetovc, në sipërfaqe prej 5689 m2 dhe ngastrën kadastrale P-.....-.....-0 ZK Kmetovc, në sipërfaqe prej 1898 m2, ne dinarë te atëhershëm Jugosllav, të cilin çmim e kishte paguar në tërësi me rastin e

blerjes ku edhe ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të pa ndërprerë në këto dy ngastra, e që tani i shfrytëzon djali i tij paditësi, pa u penguar nga askush e as nga ana e të paditurve.

Gjykata në kuptim të nenit 394 dhe 395 të LPK-ës, i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi të paditurve, në mënyrë që te njejtit të paraqesin përgjigje lidhur me pretendimet e paditësit. Në përgjigjen në padi, përfaqësuesi i të paditurve i autorizuari i tyre S. Z., e ka pohuar në tersi padin dhe kërkespadin e paditësit.

Gjykata ka caktuar seancë gjyqësore për datën 01.10.2024, në të cilën paditësi si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe thënjeve në këtë seancë duke i propozuar gjykatës që të aprovohet propozimit i tij dhe të vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrave kadastrale se paditësi në bazë të mbajtjes, edhe ate është pronar i ngastrave P-.....-.....-0 ZK Kmetovc, në sipërfaqe prej 5689 m2 ne vendin e quajtur “S.Z.” dhe ngastrën kadastrale P-.....-.....-0 ZK Kmetovc, në sipërfaqe prej 1898 m2, në vendin e quajtur “V.....”, ashtu që detyrohen te paditurit që t’ia njohin këtë të drejtë paditësit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Përfaqësuesi i të paditurve S..... Z....., ka deklaruar se mbetet në tersi pranë përgjegjies në padi, duke i propozuar gjykatës që të bie aktgjykim në bazë të pohimit. Ka shtuar se eshte e vertete qe babai i paditsit i ka blere ngastrat kadastrale te cekura ne padi, nga te paditurit, te paditurit e kane pranuar çmimin e kontraktuar dhe nuk kane asnjë pretendim ndaj këtyre ngastrave.

Gjykata ka konstatuar se të drejtat që janë objekt i këtij raporti civilo-juridik janë në disponimin e të drejtave të palëve, prandaj në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-ës), me të cilin përcaktohet se “në qoftëse i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimin në bazë të pohimit), andaj vendosi që pa shqyrtim të mëtejshëm t’ia aprovojë kërkesëpadinë e paditëses si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të LPK-ës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, e bazuar në nenin 394, 395, 143 dhe 148 të LPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr. 553/22 më datë 14.10.2024**

**Gj y q t a r j a,**  
Mevlide Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të të njëjtit, vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-ës, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.